



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 8 dt. 04.04.2014

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 04.04.2014, pasi shqyrtoi projektet e diskutuara në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. **Miratohet** propozimi për objektin e shpallur në mbrojtje paraprake: “*Fortifikimi i një banese feudale*” në rrugën “*Thoma Kalefi*”, Elbasan dhe projekti i mbulimit.
2. **Miratohet** “*Projekt Restaurimi i kishës së Shën e Premtes, Valsh, Elbasan*”.
3. **Miratohet** “*Projekt Restaurimi i mureve të Kalasë së Durrësit*”:
 - Mbushja e zgavrave të murit të realizohet me të njëjtën teknikë ndërtimi si origjinali.
4. **Miratohet në parim** “*Projekti i sinjalistikës për Durrësin*”. Përmbajtja (përshkrimi) i të gjitha tabelave në dy gjuhë, (shqip-anglisht), të përcillet pranë IMK-së, anëtarëve të KKR-së dhe Institutit të Arkeologjisë për verifikim si dhe të bëhen ndryshimet sipas sugjerimeve të propozuara.
5. **Nuk miratohet:** *Projekt “Konservimi dhe Restaurimi i Urës së Goricës”, Berat:*
 - Pas një konsulte me Ministren e Kulturës, Kryetarin e Bashkisë Berat, CEZ dhe Ujësjetës Kanalizimeve Berat, të hartohet projekti i zhvendosjes së tubave të ujësjetës & CEZ.

6. Lidhur me propozimin për shpallje “monument kulture” të Lëndinës “Kuvendet e Malsisë” Tropojë, KKR vendosi:

- *Materiali t'i përcillet Institutit të Historisë për oponencë, mbi vlerat historike që mbart ky objekt.*

7. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.

8. Ngarkohet Sekretaria Teknike, për njoftimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI



SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI